

NDRYSHIMET, SFIDAT DHE MUNDËSITË NË PUNËSIM TEK GRATË NË
KOMUNËN E LIPJANIT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË SOCIOLOGJI

nga

Pranvera Shabani



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
Prishtinë

MARS, 2024

NDRYSHIMET, SFIDAT DHE MUNDËSITË NË PUNËSIM TEK GRATË NË KOMUNËN E LIPJANIT

Mentor: Prof. Ass. Dr. Gëzim Selaci

Kandidate: Pranvera Shabani

Punimi “Ndryshimet, sfidat dhe mundësitë në punësim tek gratë në Komunën e Lipjanit” mbrohet nga Pranvera Shabani për marrjen e gradës Master i Arteve në Sociologji.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të paraqesim punën e grave të Komunës së Lipjanit në zonën rurale dhe atë urbane dhe të analizojmë dhe krahasojmë profesionet dhe statusin e tyre, duke u bazuar në faktorët demografik, social dhe ekonomik.

Metodologjia e përdorur

Metoda bazë e hulumtimit është metoda kualitative, ku janë shfrytëzuar të dhënat primare dhe sekondare. Duke filluar me leximin dhe analizimin e hulumtimeve, librave, artikujve të ndryshëm të autorëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Për mbledhjen e të dhënave në terren është përdorur intervista e thellë e gjysmëstrukturuar. Intervistat janë realizuar me gra të profileve të ndryshme. Përzgjedhja e grave pjesëmarrëse është bërë në mënyrë të qëllimshme, duke u bazuar në këto aspekte: mosha (25-58), gra, vendbanimi, statusi martesor, niveli arsimor, profesioni dhe përkatësia etnike. Punimi nisët nga këto pyetje hulumtuese:

- Sa dhe si ka ndryshuar roli i gruas në raport me punën?
- Cilat janë sfidat me të cilat përballen gratë në Lipjan për të arritur qëllimet e tyre të punësimit?
- Ku janë të fokusuara gratë e Komunës së Lipjanit sa i përket aspektit të punës?
- Çfarë mundësi po iu ofrohet grave të Komunës së Lipjanit për tu punësuar?

Hipoteza e hulumtimit është se ekziston një ndryshim i marrëdhënieve prej ndikimeve ekonomike, demografike dhe familjare në punën e grave të Komunës së Lipjanit. Gratë beqare kanë më shumë çasje në punë, për shkak që kanë më shumë kohë për përkushtim ndaj aspiratave të tyre. Gratë e martuara në anën tjetër duhet të përshtasin aktivitetin riprodhues dhe shtëpiak me atë të punës së paguar. Poashtu, sfidat nëpër të cilat kalojnë gratë ndikojnë në zbehjen e

interesimit të tyre për ti realizuar qëllimet e tyre dhe për të krijuar një profesion të caktuar. Ndërsa, mundësitë që u ofrohen grave të kësaj komune janë të rralla, për shkak të mungesës së ofrimit të politikave adekuate dhe zbatimin e tyre në forma të duhura.

Struktura e këtij punimi është e ndarë në shtatë (7) kapituj, që paraqiten shkurtimisht në vijim:

Kapitulli i parë: Në këtë kapitull është hyrja e punimit ku janë paraqitur disa shpjegime për të sqaruar praninë e vazhdueshme të ndarjes në baza gjinore. Këto shpjegime përfshijnë argumentet biologjike, teorinë e socializimit dhe teorinë social-strukturore. Dy qasjet e para theksojnë kryesisht karakteristikat individuale, ndërsa e treta thekson rolin që luan organizimi strukturor i shoqërisë. Po ashtu ky kapitull përmban të dhëna historike për gratë në fuqinë punëtore.

Kapitulli i dytë: Në këtë kapitull është paraqitur metodologjia e punimit, ku jepen detaje mbi hulumtimin empirik. Këtu shtjellohet lloji i intervistave, ofrohen të dhënat demografike të grave të intervistuar, po ashtu tregohet rreth procedurës së punimit.

Kapitulli i tretë: Në këtë kapitull janë të paraqitura rezultatet e intervistave të zhvilluara gjatë hulumtimit. Janë të paraqitura pikëpamjet e grave mbi punën dhe profesionin e tyre si dhe arsyet e zgjedhjes së profesionit. Poashtu, është përshkruar rrugëtimi i gruas, niveli i paraqitjes së saj në fuqinë punëtore si dhe ndikimi i punës në identitetin e saj.

Kapitulli i katërt: Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet nga intervistat e realizuara me gratë e zonave rurale. Në përgjithësi flitet për aktivitetin e tyre ditor, ku theksohet puna që ato kryejnë në fshat dhe rolin e tyre brenda shtëpisë.

Kapitulli i pestë: Ky kapitull përmban pikëpamje të grave rreth martesës, planifikimit familjar, kontributet ekonomike të grave si dhe për obligimet familjare, balancimin e punëve të shtëpisë me punën jashtë saj.

Kapitulli i gjashtë: Ky kapitull përmban të dhëna rreth mundësive që iu ofrohen grave të Komunës së Lipjanit, në atë se çfarë politika po zhvillojnë institucionet për përfshirjen e gruas në sferën e punës. Po ashtu, janë ofruar të dhëna statistikore rreth asaj se sa është përqindja e grave të kësaj komune të kyçura në vende pune dhe në cilat fusha janë më të përfshira.

Kapitulli i shtatë: Ky kapitull ofron përmbledhje ndaj çështjeve kryesore që janë parashtruar përgjatë studimit. Po ashtu, përmban reflektime mbi hulumtimin, posaqërisht ndaj intervistave të zhvilluara.